



8

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

Nr.prot 1554, date 29.6.2005

MINISTRIA E DREJTESISË

Nr.prot 0642 date 01.07.2005

PROKURORIA E PERGJITHSHME

Nr.prot 150/, date 01.07.2005  
/3

**UDHËZIM I PËRBASHKET**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR  
MBLEDHJET E KOMISIONIT TE VLERËSIMET TE MASAVE TE  
POSAÇME TE MBROJTJES SE DËSHMITAREVE DHE  
BASHKËPUNËTOREVE TE DREJTËSISË**

Ne mbështetje te pikës 4 , te nenit 102 te Kushtetutës dhe pikës 8 te nenit 6 te Ligjit nr. 9205, date 1.5.03.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe te Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë",

**UDHËZOJMË:**

1. Komisioni për Vlerësimin e Masave te Posaçme te Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë, me poshtë i quajtur "Komisioni", është organi i cili ushtron kompetencat e parashikuara ne Ligjin Nr. 9205, date 15.3.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë".
2. Anëtare te Komisionit janë ata persona te cilët emërohen sipas paragrafit 2 te nenit 6 te Ligjit Nr. 9205, date 15.3.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë" dhe qe plotësojnë kriteret e parashikuara ne paragrafin 4 te nenit 6 te Ligjit te sipërcituar. Këta persona pajisen me

certifikate sigurie, nga Departamenti i Informacionit te Klasifikuar. Po i njëjti kriter i aplikohet anëtareve alternative.

3. Kryetari i Komisionit, ose ne mungese te tij zëvendës Kryetari, thërret mbledhjen brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës prej Prokurorit te Përgjithshëm, duke njoftuar për datën, vendin dhe orën e mbledhjes, te gjithë anëtarët e Komisionit. Ne njoftimin me shkrim qe u dërgohet anëtareve te Komisionit, ju jepet bashkëlidhur rendi i ditës dhe dokumentet te cilat do te diskutohen ne te, Njoftimi anëtareve te Komisionit ju dërgohet ne zarf te mbyllur me mbishkrimin "konfidencial".
4. Njoftimi për mbledhje ju dërgohet edhe anëtareve alternative te Komisionit, duke respektuar te njëjtat procedura dhe forme te dërgimit te dokumentacionit. Anëtareve alternative ju dërgohet vetëm ftesa për datën dhe orën e mbledhjes, dhe ne rast se anëtari, te cilin anëtari alternativ duhet te zëvendësoje, nuk merr pjese ne mbledhje, atëherë atij i dërgohet edhe dokumentacioni tjetër.
5. Ne rast te kërkesave urgjente dhe për raste te veçanta, kërkesat e parashikuara ne pikat 2 dhe 3 te këtij Udhëzimi nuk respektohen dhe njoftimi mund te behet nëpërmjet telefonit apo faksit, ne asnjë rast mbledhja nuk duhet te jete me vone se 24 ore nga marrja e kërkesës.
6. Dokumentacioni i kërkuar nga ligji Nr. 9205, date 15.3.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë", përgatitet nga Sektori i Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë, me poshtë i quajtur "Sektori", dhe i vihet ne dispozicion Kryetarit te Komisionit, i cili Ben shpërndarjen e tij nëpërmjet Sektorit. Kur zhvillohen mbledhje urgjente dhe për raste te veçanta, dokumentacioni ju vihet ne dispozicion anëtareve ne momentin e zhvillimit te mbledhjes.
7. Anëtarët e Komisionit janë te detyruar te marrin pjese ne mbledhjet e tij, eproret direkt, apo punëdhënësit e tyre nuk duhet tu nxjerrin pengesa për pjesëmarrje ne to. Anëtari nuk merre pjese ne mbudhje vetëm për arsye objektive, dhe ne këto raste njofton urgjentisht Kryetarin e Komisionit, dhe Sektorin, ne mënyre qe këta te fundit te marrin masa për te njoftuar anëtarin alternativ.
8. Mbledhjet zhvillohen ne vendin e përcaktuar ne njoftim dhe drejtohen nga Kryetari i Komisionit. Te drejtën për te marre pjese ne mbledhje, përveç anëtareve te Komisionit e kane përgjegjësi i Sektorit dhe specialistet e Sektorit, përfaqësues te autorizuar te Prokurorit te Përgjithshëm. Ata thirren ne mbledhje kur një gjë te tille e çmojnë te arsyeshme anëtarët e Komisionit, për te dhëne shpjegime apo sqarime rreth çështjeve qe diskutohen apo për

dokument te ndryshme. Personat e ftuar nuk kane te drejte te marrin pjese ne mbledhje gjate procesit te votimit.

- a. Me fillim e mbledhjes Kryetari i Komisionit ju kërkon anëtareve te Komisionit, menjëherë pas deklarimit te hapjes se seancës, te deklarojnë nen përgjegjësinë e tyre nëse ekziston ndonjë nga shkaqet e përmendura ne nenin 6 pika 7 te Ligjit NR. 9205, date 15.3.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë", qe pengojnë ushtrimin e funksionit
- b. Nëse ndonjë nga shkaqet e përmendura ne piken 9 pengon arritjen e kuorunit te nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, kjo e fundit shtyhet për jo me tepër se 24 ore, duke zëvendësuar anëtarin e penguar me zëvendësin alternativ te tij.
- c. Komisioni, ne funksion te ushtrimit te veprimtarisë se tij, ka vulën e vete, me ketë sigël:
  - Stema e Republikës se Shqipërisë,
  - Republika e Shqipërisë,
  - Komisioni për Vlerësimin e Masave te Posaçme te Mbrojtës se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë,
- d. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Komisioni për Vlerësimin e Masave te Posaçme te Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë, Sektori i Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë dhe Strukturat përkatëse ne Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I REKORDIT PUBLIK  
Igli TOSKA  
TIRANE  
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

MINISTRI I DREJTËSISË  
Fatmir XHAFER  
REPUBLICA E SHQIPËRISË - SEKTOR I DREJTËSISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

PROKURORI I PËRGJITHSHEM  
Theodhori SOLLAKU  
REPUBLICA E SHQIPËRISË - ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHEM  
TIRANE

